



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Raporti për Përmbushjen e Obligimeve të Komunave nga
Agjenda Evropiane për periudhën Janar -Dhjetor 2019

Prishtinë, 2020

Përmbajtja

Përmbajtja.....	1
Shkurtesat.....	2
Hyrje.....	3
Përmbledhje Ekzekutive	4
I. Kriteret Politike.....	7
1.1. Administrata Publike.....	7
1.2. Avokati i Popullit.....	12
1.3. Shoqëria Civile	13
1.4. Lufta Kundër Terrorizmit.....	14
1.5. Të Drejtat e njeriut dhe Mbrojtja e Minoriteteve	15
1.6. Mbrojtja dhe Promovimi i Trashëgimisë Kluturore	19
II. Kriteret Ekonomike	23
2.1. “One –Stop Shop-et”	23
2.2. Ekonomia e tregut	24
2.3. Tatimet	25
III. Standardet Evropiane	27
3.1. Bujqësia dhe zhvillimi rural	27
3.2. Energjia	28
3.3. Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore.....	29
3.4. Drejtësia, drejtësia dhe Siguria	33
3.5. Migracioni	34
3.6. Arsimi dhe Kultura.....	35
3.7. Mjedisi	37
3.8. Bujqësia Lokale	40
3.9. Zhvillimi Rajonal.....	42
3.10. Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit publik.....	43
Rekomandimet	Error! Bookmark not defined.

Shkurtesat

AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
AKK	Agjensioni Kundër Korrupsionit
APK	Agjensioni Pyjor i Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
CRPK	Programi për të Drejtat Civile Kosovë
DKA	Drejtoria për Kulturë dhe Arsim
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
KPMSHCK	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës
KE	Komisioni Evropian
KKSB	Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi
KRPP	Komisioni Rregullativ i Porukrimit Publik
LVL	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
NJDNJ	Njësia për të Drejtat e Njeriut
OJQ	Organizata Jo Qeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
PZHK	Plani Zhvillimor Urbane
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim – Asociimit
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
SHFMU	Shkolla fillore e Mesme e Ultë
SHML	Shkolla e Mesme e Lartë
TAIEX	Asistenca Teknike dhe Shkëmbimi i Informacionit
UNHCR	Komisioni i Lartë i Kombëve të Bashkuara për Refugjatët
ZKA	Zyra e Kombëtare e Auditorit

Hyrje

Me qëllim të realizimit sa më të drejtë të kompetencave nga ana e komunave, viteve të fundit MAPL-ja është duke i kushtuar kujdes të veçantë avancimit dhe modernizimit të administratës së komunave, forcimit të ligjshmërisë së aktiviteteve të organeve të komunave dhe ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe teknike, në koordinim dhe në përputhje të plotë me Planin Kombëtarë për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) dhe dokumenteve tjera të Institucioneve të BE-së. Ky është qëllimi dhe synimi edhe i Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale, posaçërisht në përgatitjen e fazës fillestare në hartimin e politikave konkrete, të cilat kanë impakt të drejtpërdrejtë në përmirësimin e qeverisjes lokale në vend.


Duke pasur parasysh se PKZMSA është dokument ligjërish i detyrueshëm për të gjitha Institucionet e Kosovës, MAPL-ja është e përkushtuar në përmbushjen e obligimeve të komunave që dalin nga Agjenda Evropiane. Lidhur me këtë, MAPL ka marrë përgjegjësinë për zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të tij në kuadër të fushëveprimit të kompetencave të nivelit lokal, respektivisht ashtu siç parashihet në kuadër të planit të integruar dhe planeve individuale për komunitet. Këtë rol koordinues mes MIE dhe komunave, MAPL e finalizon me rastin e raportimit periodik për zbatimin e PKZMSA-së. Ky raport paraqet aktivitetet dhe progresin e administratës lokale në Republikën e Kosovës për periudhën Janar – Dhjetor 2019, në përmbushjen e obligimeve komunale që dalin nga Agjenda Evropiane e vendit, respektivisht duke u bazuar në PKZMSA dhe dokumentet tjera. Raporti ka rol të rëndësishëm dhe domethënës mbi zhvillimin e aktiviteteve të komunave, marrë parasysh përgjegjësinë që kanë komunitet në raport me qytetarët dhe institucionet publike. Raporti në fjalë pasqyron gjendjen reale të arriturave të komunave, por njëkohësisht edhe të sfidave për të ardhmen.

Raporti përqendrohet në fushat kryesore të aktiviteteve të cilat kanë të bëjnë me kriteret politike, kriteret ekonomike dhe standardet evropiane. Qëllimi i këtij raporti është prezantimi dhe ofrimi i të dhënave të komunave për qytetarët, institucionet vendore dhe ndërkombëtare, organizatat joqeveritare si dhe çdo grupi tjetër të interesit për nivelin e të arriturave dhe sfidave, bazuar në kriteret e përcaktuara nga Bashkimi Evropian.

Përmbledhje Ekzekutive


Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë raportuar nga 38 komuna. Mbledhja e të dhënave dhe përpunimi i tyre bazohen në metodologji dhe udhëzime të qarta, të hartuara paraprakisht nga MAPL-ja dhe duke u bazuar në udhëzimet e MIE-së, të cilat janë shpërndarë në të gjitha komunat.

Sa i përket strukturës së gjithmbarshme, ky raport përmban tre kapituj dhe është i ndarë në dy pjesë: pjesa përmbledhëse dhe ajo sektoriale. Pjesa përmbledhëse (kapitulli i parë) paraqet një pasqyrë të përgjithshme mbi zbatimin e obligimeve të komunave që dalin nga agjenda evropiane e vendit gjatë periudhës raportuese, ndërsa pjesa tjetër përbën pjesën kryesore të raportit dhe është i ndarë në tri pjesë: pjesa mbi kriteret politike, ajo mbi kriteret ekonomike dhe pjesa mbi standardet evropiane - përafrimi i legjislacionit kombëtar me *acquis*-në e BE-së. Gjithashtu, raporti përbën edhe pjesën e rekomandimeve duke identifikuar sfidat e komunave dhe mundësitë për progres.




Grafikoni 1: Përmbushja e kriterëve Politike

Nga grafiku i më sipërm shohim se në këtë periudhë raportuese Janar – Dhjetor 2019, komunat kanë arritur të përmbushin 71% të obligimeve komunale që dalin nga Agjenda Evropiane, respektivisht në kuadër të fushës së kriterëve politike.



Grafikoni 2: Përmbyshja e Kriteve Ekonomike


Në kuadër të plotësimit të kriteve apo përmbyshjes së obligimeve të tyre që dalin nga Agjenda Evropiane në fushën ekonomike, komunat kanë arritur që të përmbyshin 71% të këtyre obligimeve.



Grafikoni 3: Përmbyshja e Standardeve Evropiane

Fusha e Standardeve Evropiane është fusha më ngarkuar e Agjendës Evropiane, mbi bazën e së cilës burojnë obligime për institucionet lokale të Republikës së Kosovës. Në kuadër të kësaj fushe, nga grafikoni i paraqitur më lartë shohim 66% të obligimeve

komunat kanë arritur që të përmbushin nga fusha standardeve evropian, ndërsa MAPL do të vazhdoj bashkëpunimin më tutje me komunat për realizimin e aktiviteteve të pa realizuara.




Grafikoni 4: Përmbushja e obligimeve komunale sipas Agjendes Evropiane

Në bazë të të dhënave të paraqitura më lartë për tri pjesët e përcaktuara, kemi nxjerrë mesataren e nivelit të përmbushjes së obligimeve për komunat e Republikës së Kosovës që dalin nga Agjenda Evropiane e vendit. Nga grafikoni i 4 i paraqitur më lartë shohim se komunat, për periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2019, kanë arritur që të përmbushin 69% të obligimeve të tyre. Nga kjo mund të konstatojmë se në nivelin e përmbushjes së këtyre obligimeve mbetet ende punë për tu bërë nga institucionet lokale të vendit si dhe qeveria e vendit në krijimin e kushteve dhe mbështetjes së komunave për tejkalimin e sfidave të identifikuara për komunat.

Kriteret Politike


1.1. Administrata Publike

Nga të dhënat e paraqitura në këtë grafik, shohim se gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019, nga gjithsejtë 38 komuna programin e trajnimeve e kanë hartuar **33** komuna, ndërsa **5** komuna (*Klllokot, Mamushë, Mitrovicë e Veriut, Shtërpçë, Zubin Potok*) nuk e kanë hartuar.



Grafikoni 5: Programi i trajnimeve i hartuar sipas komunave

Nga grafiku i mëposhtëm shohim se, në 31 komuna janë mbajtur 938 trajnime për zyrtarët komunal ndërsa 7 komuna (*Ranillug, Zubin Potok, Kamenicë, Pejë, Vushtrri, Klllokot, Mitrovicë Veriore*) nuk kanë mbajtur asnjë trajnim. Kurse sa i përket data bazës për menaxhimin e programit të trajnimit e posedojnë gjithashtu 28 komuna ndërsa 10 komuna (*Ranillug, Zubin Potok, Klllokot, Zveçan, Fushë Kosovë, Klinë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq Shtërpçë, Novobërdë*) nuk e posedojnë data bazën për trajnime.



Grafikoni 6: Pjesëmarrja e komunave në trajnime dhe numri i zyrtarëve të trajnuar sipas fushave

Numri i zyrtarëve të komunës që kanë marrë pjesë në trajnime në 24 komuna është 942 ndërsa 14 Komuna (*Ranillug, Partesh, Mitrovicë Veriore, Klllokot, Mamushë, Shtërpçë, Pejë, Obiliq, Leposaviq, Kamenicë, Dragash, Deçan, Zubin Potok, Ferizaj*) nuk kanë zyrtarë të trajnuar.


Gjatë periudhës raportuese në kuadër të administratës komunale gjithashtu janë punësuar edhe zyrtarë të rinjë, në 32 komuna numri i zyrtarëve të cilët janë punësuar gjatë vitit 2019 është 348 dhe 8 avancime, ndërsa në 6 komuna (*Ranillug Zubin Potok, Partesh, Mitrovicë e Veriut, Graçanicë, Junik*) nuk kanë pasur të punësuar.

Sa i përketë përgaditjeve të cilat i kanë bërë Komunat për zbatimin e tri ligjeve korniz (Ligjit për Zyrtarë Publik, Ligjit për organizimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura dhe Ligjit për Pagat në sektorin publik, nga të dhënat e ofruara nga Komunat rrezulton se 18 Komuna kanë bërë disa përgaditje paraprake sa i përketë zbatimit të këtyre ligjeve: kanë orgaznizuar trajnime me zyrtar komunal, tryeza të ndryshme, janë njoftuar të gjithë shërbyesit civil të Komunës për këto Ligje, ndërsa 20 komuna (*Shtime, Ranillug, Gjilan, Zubin Potok, Viti, Istog, Hani Elezi, Zveçan, Prishtine, Prizren, Deçan, Junik, Kaçanik, Klinë, Rahovec, Skenderaj, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Suharekë dhe Lipjan*) nuk kanë ndërmarr ndonjë veprim.

Gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2019, në 29 Komuna janë ndërmarrë aktivitete për ngritjen e kapaciteteve institucionale për përmirësimin e menaxhimit të financave

publike si: janë caktuar personat përgjegjës në bazë të planit të veprimit, është investuar në ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve të ndryshme me qëllim të ngritjes së aftësisë së stafit aktual dhe të ri për menaxhimin e financave publike, zhvillime të takimeve etj, ndërsa 9 komuna (Ranillug, Deçan, Graçanicë, Kaçanik, Rahovec, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Mamushë, Novobërdë) nuk ka ndërmarr ndonjë aktivitet.

Nga të dhënat e ofruara sa i përketë rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit nga gjithsej 38 komuna sa kanë raportuar, 31 komuna kanë pranuar 420 Rekomandime, ndërsa 7 Komuna (Fushë Kosovë, Kamenicë, Obiliq, Pejë, Mamushë, Partesh, Mitrovicë Veriore) ZKA nuk kanë ofruar të dhëna.



Grafikoni 7: Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike sipas komunave

Sa i përket transparencës së punës dhe vendimmarrjes të nivelit lokal në 36 komuna ka pasur 936 kërkesa për qasje në dokumente publike, ndërsa në 2 komuna (Zveçan, Zubin Potok) nuk kanë pasur ndonjë kërkesë.

Me qëllim të rritjes së Transparencës në nivel lokal, nga 38 komuna sa kanë raportuar, në 19 Komuna është hartuar Strategjia për Komunikim dhe marrëdhënie me Publikun, ndërsa 19 Komuna tjera (Gjakovë, Ranillug, Gjilan, Zubin Potok, Viti, Istog, Partesh, Zveçan, Prishtinë, Mitrovicë, Kamenicë, Glogoc, Junik, Kaçanik, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Suharekë, Mamushë) nuk e kanë hartuar ende këtë Strategji.

Në 33 komuna janë publikuar në ueb faqen e komunës të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga organet e komunave në gjuhët zyrtare, në 3 komuna (Novobërdës, Malishevë,

Hani Elezit) *pjesërisht* janë publikuara si dhe në 2 komuna (Zubin Potok, Mitrovicë Veriore) nuk janë publikuar.


Mbledhjet e kuvendeve të komunave në 23 komuna janë duke u transmetuar përmes ueb faqes komunale, ndërsa në 15 Komuna (Shtime, Ranillug, Zubin Potok, Istog, Klllokot, Hani Elezi, Zveçan, Podujevë, Partesh, Graçanicë, Klinë, Leposaviq, Shtërpçë, Novobërd dhe Obiliq) nuk janë transmetuar për shkak të problemeve si: *mungesë të zyrtarit të IT-së, mosfunksionimi i ueb faqes së komunës etj.* Gjithashtu në disa komuna egzistojn edhe forma të tjera të transmetimit të mbledhjeve përveq ueb-faqeve si: *teleprezneca, media lokale, rrjete sociale etj.*

Sa i përket takimeve publike gjithëpërfshirëse me qytetarët (konform nenit 68.1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale) në 32 komuna janë mbajtur 181 takime ndërsa 6 komuna (Deqan, Fushë Kosovë, Leposaviq, Viti, Partesh, Zubin Potok) nuk është mbajtur asnjë takim publik.

Kurse takime konsultative me qytetarët lidhur me propozim aktet e kuvendit të komunës në 32 komuna janë mbajtur 251 takime ndërsa në 6 komuna (Zubin Potok, Deqan, Leposaviq, Pejë, Shtërpçë, Mamushë) nuk është mbajtur asnjë takim konsultativ.

Komunat gjithashtu kanë raportuar edhe sa i përketë vështirësive të cilat ndikojnë në zbatimin e Ligjeve, Rregulloreve, politikave dhe procedurave tjera komunale, dhe nga të dhënat e pranuar del se në përgjithësi në nivel lokal vështirësi janë kryesisht: mungesa e harmonizimit të ligjeve, mungesa e informimit të qytetarëve, mungesa e buxhetit etj.

Me qëllim të rritjes së pjesëmrrjes së qytetarëve në Konsultime publike 35 komunat kanë ndërmarrë disa veprime si: *janë mbajtur fushata sensibilizuese, është zgjeruar rrjeti i njoftimeve publike, janë bërë me kohë njoftimet etj,* ndërsa 3 komuna (Leposaviq, Junik, Kaçanik) nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim në këtë drejtim.




Grafikoni 8: Numri i konsultimeve dhe takimeve publike të mbajtura sipas komunave

Në 37 komuna është themeluar komiteti për komunitete, ndërsa në komunën e Dragashit nuk është themeluar në bazë të Ligji për Barazi Gjinore. Numri i mbledhjeve të Komitetit për Komunitete gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019 është 374.

Gjithashtu janë ndërrmar veprime nga komunat që komunitetet jo-shumicë të përfaqësohet në mënyrë adekuate në institucionet publike: *si respektimi i ligjeve në fuqi për përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë, janë mbajtur fushta vetëdijësuese, formimi i zyrës komunale për komunitete dhe kthim etj.*


Sa i përket të punësuarëve të komuniteteve jo shumicë në institucionet publike në 28 komuna përqindja e të punësuarve është 10.65%, ndërsa 4 komuna (*Deçan, Shtërpçë, Graçanicë dhe Partesh*) kanë të punësuar 168 persona nga komuniteti pakicë, si dhe 6 komuna (*Gjakovë, Glogoc, Mamushë, Junik, Kaçanik, Kllot*) nuk kanë ofruar të dhëna.



Grafikoni 9: Numri i minoriteteve të punësuar dhe numri i mbledhjeve të komunitetit

1.2. Avokati i Popullit

Kujdes i veçantë për organizimin dhe funksionimin e zyrave të Avokatit të Popullit në komunat përkatëse, i është kushtuar qasjes së gjithë qytetarëve në këto zyra. Për këtë qëllim në 27 komuna sipas raportimeve të bëra rezulton se të gjitha lokalet dhe hapësirat e punës së institucionit të Avokatit të Populli janë të qasshme për personat me aftësi të veçanta, ndërsa në 11 komuna (*Gjakovë, Malishevë, Zubin Potok, Gjilan, Deçan, Graçanicë, Kaçanik, Rahovec, Mitrovicë e Veriut, Shtërpçë, Vushtrri*) nuk kanë qasje.



Grafikoni 9: Paraqitja e Nivelit dhe procesit të kërkesave të Avokatit të Popullit sipas komunave

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019, në 6 komuna (Gjakovë, Gllogoc, Fushë Kosovë, Prishtinë, Prizren, Skenderaj) kanë pasur 27 kërkesa/rekomandime nga institucioni i Avokatit të Popullit. Ndërsa 32 komuna nuk kanë pranuar asnjë kërkesë apo rekomandim nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Lidhur me këto kërkesa, 6 komuna (Gjakovë, Gllogoc, Fushë Kosovë, Prishtinë, Prizren, Skenderaj) kanë kthyer 20 përgjigje pozitive Intitucionit të Avokatit të Popullit..

1.3. Shoqëria Civile


Me qëllim të përkrahjes së aktiviteteve të OJQ-ve, në 29 komuna buxheti i planifikuar është 5,620,801.46€, ndërsa 9 komunë (Zubin Potok, Istog, Klllokot, Partesh, Zveçan, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Junik) nuk kanë planifikuar buxhet gjatë kësaj periudhe raportuese. Numri i OJQ-ve të përkrahura në 32 komuna është 942 OSHC, ndërsa në 6 komunë (Zubin Potok, Klllokot, Partesh, Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Shtërpçë) asnjë OSHC nuk është përkrahur.

1.4. Lufta Kundër Terrorizmit

Lidhur me vetëdijësimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shpiej në ekstremizëm të dhunshëm në 23 komuna janë ndërrmar veprime si në vijim: *fushata vetëdijësuese, aktivitete në teren, takime të rregullta me anëtarët e KKSBB-së, takime me përfaqësues të komuniteteve fetare, janë mbajtur aktivitete për parandalimin e dukurive negative në institucionet e arsimit parauniversitar dhe me rinin shollore etj, ndërsa 15 komuna (Malishevë, Ranillug, Zubin Potok, Zveçan, Prishtinë, Podujevë, Graçanicë, Junik, Klinë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Vushtrri, Mamushë, Novobërd) nuk kanë ndërrmarë asnjë veprim/aktivitet për vetëdijësimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shpiej në ekstremizëm të dhunshëm.*

Gjatë periudhës raportuese në 36 Komuna nuk ka pasur asnjë rast që është raportuar në KKSBB për aktivitete që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin, ndërsa në 2 komuna (Viti, Dragash) ka pasur 2 raste.

Në 34 komuna numri i personave zyrtar që bërë deklarinë e pasurisë tek AKK është 1480 ndërsa 4 komuna (Ranillug, Mamushë, Partesh, Mitrovicë Veriore) nuk kanë ofruar të dhëna. Në 35 komuna asnjë zyrtar komunal nuk ka deklaruar konflikt të interesit ndërsa në 3 komun (Deqan, Skenderaj, Zveqan) numri i deklarimeve të konfliktit të intersit nga zyrtarët komunal është 97.



Grafikoni 10: Paraqitja e numrit të personave zyrtar që e deklarojnë pasurinë sipas komunave

Në 32 komuna nuk ka pasur asnjë rast nga anëtarët e kuvendit që kanë deklaruar konfliktin e interesit para marrjes së vendimeve në kuvend, ndërsa në 6 komunë (Zveçan, Mamushë, Lipjan, Deçan, Skenderaj, Kaçanik) kanë qenë 75 raste.

Për zbatimin e ndryshimeve të fundit ligjore për suspendimin e zyrtarëve të dyshuar për korrupsion, respektivisht atyre të dënuar në korrupsion (bazuar në ndryshimet e fundit të kodit penal dhe kodit të procedurës penale) në 10 komuna janë ndërrmar veprime duke identifikuar zyrtarët e dyshuar të korrupsionit si në raste të caktuara janë pezulluar nga puna, janë organizuar punëtori për këtë fushë, ndërsa në 28 komuna (Ranillug, Zubin Potok, Malishevë, Gjilan, Deçan, Dragash, Glogoc, Junik, Kaçanik, Rahovec, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Vushtrri, Mamushë, Novobërdë, Suharekë, Prishtinë, Prizren, Podujevë, Mitrovicë, Kamenicë, Viti, Istog, Klokot, Hani Elezi, Partesh, Zveçan) nuk është bërë asnjë përgatitje.


Ndërsa sa i përket përgaditjeve për ndryshimet më të fundit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e detyrës zyrtare në 17 komuna kanë bërë përgaditje dhe është emëruar zyrtari për parandalimin e konfliktit të interesit si dhe është trajnuar për fushën e caktuar, ndërsa në 21 komuna (Malishevë, Ranillug, Gjilan, Zubin Potok, Viti, Istog, Klokot, Hani Elezi, Zveçan, Prishtinë, Fushe Kosovë, Mitrovicë, Kamenicë, Kaçanik, Rahovec, Leposaviq, Shtërpçë, Vushtrri, Mamushë, Novobërdë dhe Suharekë) nuk është bërë përgatitje.

Planin Lokal për Integritet e kanë hartuar 20 komuna, ndërsa 18 komuna (Gjakovë, Ranillug, Gjilan, Zubin Potok, Klokot, Zveçan, Prishtinë, Prizren, Kamenicë, Deçan, Dragash, Junik, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Obiliq, Mamushë, Novobërdë) nuk është hartuar ende ky plan. Gjithashtu 13 komuna kanë caktuar zyrtarin që raporton për zbatimin e Planit Lokal për Integritet, ndërsa 25 komuna (Gjakovë, Malishevë, Ranillug, Gjilan, Zubin Potok, Klokot, Hani Elezi, Prishtinë, Prizren, Podujevë, Fushe Kosovë, Mitrovicë, Kamenicë, Deçan, Dragash, Gracanica, Junik, Klinë, Rahovec, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Obiliq, Mamushë, Novobërdë) nuk kanë caktuar ende zyrtarin, dhe vetëm në 6 komuna janë publikuar raportet mbi monitorimin e zbatimit të Planit Lokal për Integritet.

Të Drejtat e njeriut dhe Mbrojtja e Minoriteteve

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019, shumica e komunave kanë mbajtur aktivitete të ndryshme në kuadër të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, në 24 komuna janë mbajtur mbajtur 149 aktivitete për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në fushën e shërbimeve sociale, personave të riatdhesuar, fëmijët në situatë rruge, në promovimin e barazisë gjinore, në trafikimin me qenië njerëzore etj, ndërsa në 14 komuna

(Gjilan, Zubin Potok, Gllogoc, Dragash, Kaçanik, Klinë, Novobërdë, Shtërpçë, Hani Elezit, Mamushë, Junik, Klllokot, Graçanicë, Mitrovicë Veriore) nuk është mbajtur asnjë aktivitet



Grafikoni 11: Rregullorja komunale për mbrojtjen e fëmijëve

Rregulloren komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve e kanë hartuar 22 komuna, ndërsa 16 komuna (Klllokot, Partesh, Zveçan, Mamushë, Novobërdë, Obiliq, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Malishevë, Ranillug, Zubin Potok, Shtërpçë, Dragash, Graçanicë, Junik, Klinë) nuk kanë hartuar ende.


Sa i përket rasteve të dhunës në baza gjinore në 21 komuna kanë pasur 617 raste, ndërsa 17 Komuna (Shtime, Ranillug, Zubin Potok, Istog, Klllokot, Partesh, Zveçan, Podujevë, Deçan, Graçanicë, Kaçanik Rahovec, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Novobërdë, dhe Lipjan) nuk ka pasur asnjë rast.

Për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje në 15 komuna është themeluar Këshilli Komunal për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe baza gjinore dhe janë mbajtur 39 takime, ndërsa në 23 komuna (Shtime, Ranillug, Zubin Potok, Klllokoti, Zveçan, Prizren, Podujevë, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Kamenicë, Deçan, Gllogoc, Graçanicë, Junik, Kaçanik, Klinë, Rahovec, Mitrovicë e Veriut, Shtërpçë, Vushtrri, Mamushë, Novobërdë, Viti,) nuk kanë themeluar ende këtë këshill.

Gjithashtu 7 Komuna kanë hartuar Strategjinë kundër dhunës në familje, ndërsa 31 komuna (*Shtime, Ferizaj, Malishevë, Ranillug, Zubin Potok, Istog, Kllkot, Hani Elezi, Partesh, Zveçan, Prishtinë, Prizren, Podujevë, Fushe Kosovë, Mitrovicë, Kamenicë, Viti, Deçan, Glogoc, Graçanicë, Junik, Kaçanik, Klinë, Rahovec, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Vushtrri, Mamushë, Novobërdë, Suharekë*) nuk e kanë hartuar ende këtë Strategji.

Në 28 komuna gjatë periudhës raportuese janë ndërmarrë disa aktivitetet për forcimin e mekanizmave institucionalë për mbrojtje dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve si: fushata për vetëdijësimin e prindërve të komuniteteve, janë mbajtur takime të ndryshme për të diskutuar për martesat e hershme të komuniteteve, organizimi i seancave informative, vizitat në shkolla, takim me komunitete, hulumtime etj, ndërsa në 10 komuna (*Ranillug, Zubin Potok, Kaçanik, Klinë Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Mamushë, Hani Elezit Fushë Kosovë*) nuk është ndërmarrë ndonjë aktivitet.

Gjithashtu në 28 komuna kanë ndërmarrë disa aktivitete për ngritjen e kapaciteteve instiucionale për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve, ndërsa në 10 komuna (*Ranillug, Zubin Potok, Kaçanik, Klinë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Mamushë, Hani Elezit Fushë Kosovë*) nuk është ndërmarrë asnjë veprim.



Grafikoni 13: Numri i grave në pozitë menaxheriale

Numri i përfaqësimit të grave në pozita menaxheriale duke përfshirë edhe komunitetet jo shumicë në 35 komuna është 650, ndërsa në 3 komuna (Dragash, Rahovec, Mitrovicë e Veriut) nuk kanë ofruar të dhëna.

Numri i përfaqësimit të grave në komunë, administratë dhe Kuvendin e Komunës duke përfshirë edhe komunitetet jo shumicë për 37 komuna është 2636, ndërsa Komuna e Mitrovicës Veriore nuk ka ofruar të dhëna.

Gjatë periudhës raportuese 23 Komuna gjithashtu kanë ndërmarrë aktivitetet për rritjen e përfaqësimit të grave në pozitat lokale të vendimmarrjes *me çrast janë zhvilluar disa aktivitete, takime, tryeza të rrumbullakt me qëllim të ndërgjegjësimit për përfaqësimin e grave dhe vajzave në vendimarrje* ndërsa 15 komuna (Ranillug, Gjilan, Istog, Kllkot, Hani Elezi, Podujevë, Graçanicë, Junik, Kaçanik, Klinë, Rahovec, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Mamushë) nuk kanë ndërmarr ndonjë veprim.

Me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe përmirësimit për të drejtat pronësore të grave, 34 komuna kanë ndërmarrë veprime si: *fushata sensibilizuese, tryeza, seminare, Lirimi nga taksa komunale, organizimi i seancave informative, aktivitete me grat e viseve rurale, fushata vetëdijësuese, punëtori për të drejtat pronësore etj*, ndërsa 4 komuna (Kllkot, Zveçan, Junik, Mamushë) nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim/fushatë.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019, janë paraqitur 15 raste të strehimit dhe të kompensimit të viktimave të trafikimit në 7 komuna (Ferizaj, Prizren, Mitrovicë, Viti, Fushë Kosovë, Lipjan, Gllogoc), ndërsa në 31 komuna (Shtime, Gjakovë, Gjilan, Ranillug, Zubin Potok, Malishevë, Istog, Kllkot, Hani Elezi, Partesh, Zveçan, Prishtinë, Podujevë, Kamenicë, Deçan, Dragash, Graçanicë, Junik, Kaçanik, Klinë, Rahovec, Skenderaj, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Vushtrri, Mamushë, Novobërdë, Suharekë dhe Obiliq) nuk është paraqitur ndonjë rast i strehimit dhe i kompensimit të viktimave të trafikimit.

Në 7 Komuna (Ferizaj, Prizren, Mitrovicë, Viti, Fushë Kosovë, Lipjan, Gllogoc), në të cilat janë paraqitur raste të tilla është siguruar ndihmë viktimave, ndërsa në 31 komuna nuk ka pasur raste të paraqitura.

Në bazë të raportimit të komunave shohim se në 14 Komuna ndahen fonde të qëndrueshme dhe afatgjatë për ofrimin e shërbimeve sociale, ndërsa në 24 Komuna (Gjakovë, Ranillug, Gjilan, Viti, Istog, Kllkot, Hani Elezi, Prizren, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Kamenicë, Deçan, Dragash, Junik, Kaçanik, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Vushtrri, Mamushë, Novobërdë, Suharekë, Obiliq) nuk ndajnë fonde.

Gjithashtu 15 Komuna kanë miratuar Planin trevjeçar për strehim social, ndërsa 23 komuna (Gjakovë, Malishevë, Ranillug, Gjilan, Zubin Potok, Viti, Kllkot, Hani Elezi, Partesh,

Zveçan, Prishtinë, Kamenicë, Dragash, Junik, Klinë, Rahovec, Skenderaj, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Vushtrri, Obiliq, Mamushë, Novobërdë) nuk është miratuar.

Në bazë të raporteve të komunave, shohim se 27 komuna kanë ndarë buxhet për vitin 2019 për mbrojtjen e komuniteteve pakicë, dhe shuma e ndarë është 11,028,780.00 €, ndërsa 9 komuna (*Malishevë, Ranillug, Klllokot, Partesh, Podujevë, Deçan, Skenderaj, Mitrovicë e Veriut, Shtërpçë*) nuk është ndarë buxhet, si dhe 2 komuna (*Glllogoc dhe Junik*) kanë raportuar që nuk kanë komunitete pakicë.


Ndërsa sa i përketë buxhetit për personat e riintegruar, në bazë të raportimit shohim se 10 komuna ndajnë buxhet, ndërsa në 28 komuna (*Shtime, Ferizaj, Ranillug, Gjilan, Zubin Potok, Podujevë, Istog, Klllokot, Partesh, Zveçan, Prishtinë, Kamenicë, Deçan, Graçanicë, Junik, Kaçanik, Klinë, Rahovec, Skenderaj, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Vushtrri, Obiliq, Mamushë, Novobërdë, Lipjan dhe Suharekë*) nuk ndajnë buxhet për personat e riintegruar.

Rregulloren komunale për përdorim të Gjuhëve Zyrtare e posedojnë 36 komuna ndërsa 2 komunë (*Ranillug dhe Zveçan*) nuk e posedojnë ende këtë rregullore. Kurse sa i përket stafit profesional që ka të bëjë me përkthim është rekrutuar në 26 komuna, ndërsa komuna e Podujevës pjesërisht ka të rekrutuar stafin dhe 11 komuna (*Gjilan, Zubin Potok, Hani Elezit, Kamenicës, Glllogoc, Graçanicë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Obiliq, Mamushë, Novobërdë*) nuk kanë staf të mjaftueshëm. Gjithashtu, në 28 komuna janë ndërmarrë veprime për të krijuar qasje për shërbime në gjuhët zyrtare në nivel komunal, ndërsa në 10 komuna (*Malishevë, Ranillug, Gjilan, Hani Elezit, Podujevë, Rahovec, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Vushtrri, Mamushë*) nuk kanë ndërmarr asnjë veprim.

1.5. Mbrojtja dhe Promovimi i Trashëgimisë Kulturore

Me qëllim të definimit dhe trajtimit të perimetrave, zonave të mbrojtura, sipërfaqeve të mbrojtura dhe shenjëzimit të aseteve të Trashëgimisë Kulturore, 25 komuna kanë ndërmarrë veprime konkrete, si: *janë hartuar dosjet e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe përcaktimi i perimetrit të tyre mbrojtës, është bërë identifikimi i objekteve dhe aseteve të trashëgimisë kulturore, është bërë shenjëzimi i aseteve të Trashëgimisë Kulturore, është bërë kërkesa në MKRS në Departamenti të Trashëgimisë Kulturore që këto objekte të jenë në listën e mbrojtjes si dhe janë shënuar aktivitete të ndryshme (fushata) me qëllim të ruajtjes dhe promovimit sa më të mirë për një vetëdijesim të përgjithshëm etj*, ndërsa 11 komuna (*Ranillug, Zubin Potok, Klllokot, Istog, Hani Elezi, Zveçan, Podujevë, Dragash, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Novobërdës*) nuk kanë ndërmarrë veprime. Ndërsa Komuna e Junikut dhe e Mitrovicës ka raportuar se nuk ka zona të mbrojtura.

Komuna e Prishtinës dhe ajo e Fushë Kosovës kanë ndarë parcelat përkatëse për themelimin e Muzeut të Natyrës në këto dy komuna. Veprimet tjera për themelimin dhe funksionalizimin e këtyre dy muzeve janë në kompetencë të institucioneve qendrore. Në komunën e Fushë Kosovës në periudhën raportuese është bërë studimi i fizibilitetit të projektit për sa i përket themelimit të Muzeut të Natyrës nga MKRS dhe Drejtoria e Ubanizmit dhe gjithashtu janë vendosur Gurë themelet e Muzeut në fshatin Sllatinë e Vogël i cili do të financohet nga MKRS.



Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore e posedojnë 3 komuna (Lipjan, Kaçanik, Rahovec, ndërsa 35 komuna (Viti, Istogu, Klllokot, Hani Elezi, Partesh, Zveçan, Prishtinë, Prizren, Podujevë, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Kamenicë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Shtime, Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Skenderaj, Malishevë, Mamushë,

Grafikoni 14: Plani për Trashëgimi Kulturore

Nobvobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Deçan, Glogoc, Graçanicë, Junik, Klinë, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë dhe Dragash) nuk e kanë hartuar ende këtë Plan. Planin e Veprimit për trashëgimi kulturore e kanë hartuar 2 Komuna: Dragash, Rahovec,, ndërsa në 36 komuna (Viti, Istogu, Klllokot, Hani Elezi, Partesh, Zveçan, Prishtinë, Prizren, Podujevë, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Kamenicë, Gjakovë, Gjilan, Ferizaj, Shtime, Skenderaj Vushtrri, Obiliq, Suharekë, Lipjan, Malishevë, Mamushë, Nobvobërdë, Ranillug, Zubin Potok, Deçan, Glogoc, Graçanicë, Junik, Klinë, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Dragash) nuk e kanë.

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë evidentuar 5 shkelje të rregullativës ligjore për trashëgimi kulturore apo ndërtimeve pa leje në 3 Komuna (Prizrenit, Klinë, Skenderaj). Lidhur me këtë komunat në të cilat ka pasur shkelje të evidentuara kanë ndërmarrë masa ndaj këtyre shkeljeve si: janë vendosur shiritat dhe është bërë ndërprerja e punimeve si dhe janë bërë rrënime të detyrshme.



Grafikoni 15: Numri i shkeljeve në zonat e mbrojtura

Pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave të tërësive të trashëgimisë kulturore të Kishës Ortodokse janë vendosur në 10 komuna, në 5 komuna (*Malishevë, Gjilan, Zubin Potok, Obiliq, Mamushë*) pjesërisht, ndërsa 19 komuna (*Shtime, Ferizaj, Gjilan, Prishtinë, Mitrovicë, Kamenicë, Viti, Istog, Klllokot, Hani Elezi, Partesh, Zveçan, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Kaçanik, Graçanicë, Vushtrri dhe Novobërdë*) ende nuk janë siguruar këto paisje të sigurisë për objektet e kultit fetar, si dhe 4 Komuna (*Dragash, Gllogoc, Hani Elezi, Junik*) nuk kanë kisha Ortodokse.

Sa i përket Memorandumeve të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e Kishave Ortodokse, në këtë periudhë raportuese, memorandume të nënshkruara kemi në 7 komuna, ndërsa 27 komuna (*Gjakovë, Malishevë, Ranillug, Gjilan, Zubin Potok, Viti, Istogu, Klllokot, Partesh, Zveçan, Prishtinë, Prizren, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Kamenicë, Vushtrri, Obiliq, Mamushë, Novobërdë, Lipjan, Deçan, Graçanicë, Kaçanik, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq dhe Suharekë*) nuk e kanë memorandume të nënshkruara, si dhe 4 Komuna (*Dragash, Gllogoc, Hani Elezi, Junik*) nuk kanë kisha Ortodokse.

Në kuadër të koordinimit ndërinstitutional për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore janë themeluar dhe funksionojnë Këshilli për Fshatin Hoqë e Madhe dhe Task Forca për Qendrën Historike të Prizrenit. Në komunën e Rahovecit, Këshilli i fshatit për Hoçën e Madhe është funksional.

Ndaj shkelësve të Ligjeve (Ligji për ZVM dhe Ligji për Hoçën e Madhe, dhe Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit) komunat kanë shqiptuar gjoba manadtore. Mirëpo vlen

të theksohet se gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2019 nuk ka pasur ndërtime ilegale brenda Zonave të Veçanta të Mbrojtura në Komunën e Prizrenit.

Lidhur me zbatimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit është formuar Task Forca për Qendrën Historike të Qytetit të Prizrenit, kjo Task Forcë hulumton dhe verifikon shkeljet e ligjit që bëhen në Qendrën Historike të Qytetit të Prizrenit. Gjithashtu janë siguruar të gjitha fondet dhe materialet për Këshillin e Trashëgimisë Kulturore për Qendrën historike të Prizrenit dhe kjo ka bërë këshillin të jetë më profesionale dhe t'i ndjek të gjitha aktivitetet në Qendrën historike të Prizrenit. Komuna e Prizrenit ka caktuar inspektor për të inspektuar ndërtimet pa leje në Zonën e Mbrojtur të qytetit. Secila lëndë që parashtrohet në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor (DUPH) që gjendet në kuadër të Ligjit për Qendrën Historike dërgohet në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore (QRTK) për të marrë mendimin e tyre. Respektimi i Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit-Zona e Parë e Mbrojtjes si dhe repektimit i Ligjit për Qendrën Historike.

Komuna e Prizrenit ka alokuar buxhetin në vlerë prej 57,020,00 euro € për Këshillin e Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, për të mundësuar funksionimin e suksesshëm. Ndërsa, komuna e Rahovecit ka ndarë buxhet për fshatin Hoçë e Madhe në shumë prej 22 743.00Euro.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019, për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore 24 komuna janë mbajtur takime të ndryshme sensibilizuese dhe janë shpërndarë broshura me qëllim të informimit dhe vetëdijesimit të mbrojtjessë trashëgimisë kulturore, janë organizuar ekspozita nga fusha e Trashëgimisë Kulturore dhe e Muzeologjisë, janë mbajtur workshope për promovimin e zejeve tradicionale, inicimi i hartimit të planit të konzervimit të Zonës Historike të Qytetit, rregullimin e shkollës së parë shqipe në Prishtinë, Renovimi dhe restaurimi i bibliotekës Hivzi Sylejmani, Revitalizimi i rrugës Mehmet Kaçurri (Rruga model), Projekti emergjent i shtëpisë së Sali Safqe, është iniciuar edhe projekti për Muzeun e shtëpi shkolla (Herticët) në lagjen Kodra e Trimave, si dhe në bashkëpunim me UNDP janë realizuar edhe 3 projekti, Varrezat Hebraike, Ish- Akademinë e Shkencave si dhe Parkun arkeologjik perballe Muzeut te Kosoves, ndërsa në 14 komuna (Ranillug, Gjilan, Zubin Potok, Mitrovicë, Fushë Kosovë, Klllokot, Hani Elezi, Zveçan, Dragash, Glllogoc, Rahovec, Mitrovicë e Veriut, Shtërpçë, Novobërdës) nuk është ndërmarr asnjë aktivitet.

II. Kriteret Ekonomike


2.1. “One –Stop Shop-et”

Themelimi dhe funksionalizimi i “one stop shopet” apo pikave të përbashkëta administrative në komuna për ofrimin e shërbimeve të bizneseve lokale, janë themeluar dhe funksionojnë në 28 komuna ndërsa në 10 komuna (*Ranillug, Zubin Potok, Prishtinë, Kllokot, Partesh, Zveçan, Junik, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Mamushë*) ende nuk janë themeluar (one-stop shopet).



Grafikoni 16: Komunat të cilat i kanë themeluar “one stop shop-et”

2.2. Ekonomia e tregut



Grafikoni 17: Krahësimi i numrit të bizneseve të regjistruara dhe mbyllura sipas komunave


Në 32 komuna numri i bizneseve të regjistruar është 9149, ndërsa 6 komuna (*Ranillug, Zubin Potok, Leposaviq, Zveçan, Klllokot, Mitrovicë Veriore*) nuk ka pasur biznese të regjistruara. Sa i përket mbylljes së bizneseve, për 31 komuna numri i bizneseve të mbyllura është 1216, ndërsa në 7 komuna (*Ranillug, Zubin Potok, Leposaviq, Zveçan, Klllokot, Partesh, Mitrovicë Veriore*) nuk ka pasur biznese të mbyllura.

Numri i bizneseve të udhëhequra nga gratë në 29 komuna është 2336 biznese, 7 komuna (*Ranillug, Zubin Potok, Leposaviq, Zveçan, Junik, Graçanicë, Mitrovicë Veriore*) nuk ka pasur biznese të udhëhequr nga gratë, si dhe 2 komuna (*Deçan 29% dhe Pejë 20%*) kanë ofruar të dhëna në përqindje.

Ndarja e buxhetit për subvencionimin e bizneseve, në 16 komuna është në shumë prej 623,428.30, euro, ndërsa 22 komuna (*Ranillug, Zubin Potok, Malishevë, Viti, Klllokot, Partesh, Zveçan, Prishtinë, Podujevë, Deçan, Dragash, Glogoc, Graçanicë, Junik, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Mamushë, Novobërdë, Suharekë dhe Lipjan*) nuk kanë ndarë buxhet.

Ndërsa për planifikimin e buxhetit në 32 komuna janë mbajtur 218 dëgjime publike, ndërsa në 5 komuna (*Ferizaj, Pejë, Viti, Zveçan, Mitrovicë Veriore*) nuk është mbajtur asnjë dëgjim publik. Në kuadër të planifikimit të buxhetit janë përfshirë edhe qytetarët,

shoqëria civile si dhe grupet e tjera të interesit në planifikimin e buxhetit me anë të njoftimit publik dhe takimeve të përbashkëta.



Grafikoni: Numri i dëgjimeve publike për buxhet

Në 29 komuna kanë inspektorë të tregut dhe numri i tyre është 58 inspektor, ndërsa 9 komuna (Gjilan, Zubin Potok, Leposaviq, Novobërdë, Prishtinë, Prizren, Shtërpçë, Zveqan, Mitrovicë Veriore) nuk kanë inspektor të tregut.

2.3. Tatimet

Me qëllim të parandalimit të ekonomisë jo-formale dhe evazionit fiskal, gjatë periudhës raportuese Janar - Dhjetor 2019, 31 komuna kanë ndërmarrë masa ndaj subjekteve ekonomike me qëllim të parandalimit të ekonomisë jo-formale, si: *Inspektimi i vazhdueshëm i këtyre subjekteve, vërejtjet për disa biznese me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale, ndëshkime me gjoba dhe sanksionime ligjore, konfiskime të mallit dhe ndjekjeve nga Policia, dërgimi i lëndëve në gjykatën për kundërvajtje, mbyllja e lokalit, ndërsa 7 komuna (Ranillug, Zveqan, Zubin Potok, Graçanicë Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Novobërdë) nuk kanë ndërmarrë ndonjë masa.*

Strategjinë për zhvillim ekonomik lokal e posedojnë 18 komuna, ndërsa ndërsa në 20 komuna (Gjakovë, Malishevë, Ranillug, Zubin Potok, Prishtinë, Prizren, Mitrovicë, Kamenicë,

Viti, Klllokot, Partesh, Zveçan, Vushtrri, Suharekë, Nobvobërdë, Gracanicë, Rahovec, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq) ende nuk është hartuar kjo strategji. Gjithashtu në 14 komuna strategjia për zhvillim ekonomik lokal monitorohet përmes drejtorive përkatëse.

Në përgjithësi vështirësi në planifikimin, realizimin dhe shpenzimin e qendrueshëm të financave lokale janë: *tejkalimi i vlerave të projekteve, stafi jo shumë i përgatitur për planifikimin e buxhetit, ndarja jo e mirë e kufijve të shpenzimeve me Qarkoret Buxhetore nga Ministria e Fiancave etj.* Lidhur me këtë në 28 komuna janë ndërrmar veprime për përmirësimin e menaxhimit të financave lokale sipas rekomandimit të auditorit për të cilat është bërë: *hartimi i planit të veprimit për impelentimin e rekomandimeve të dala nga zyra e auditorit të përgjithshëm, aplikimi i masave në menaxhimin financiar, funksionalizimi i E-pasurisë dhe monitorimi, janë ndërmarrë veprimë në përputhje me rekomandimet e dhëna etj,* ndërsa 10 komuna (*Gjilan, Prishtinë, Klllokot, Hani Elezi, Zveçani, Ranillug, Gracanicë, Deçan, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq*) nuk është ndërrmar asnjë veprim.

Planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve të Auditorit e posedojnë 31 komuna, 7 komunë (*Ranillug, Prishtinë, Partesh, Klllokot, Gracanicë, Deçan, Mitrovicë e Veriut*) nuk është hartuar ende ky plan.

Në 32 komuna egziston regjistri i pronës komunale, ndërsa në 6 komuna (*Zubin Potok, Fushë Kosovë, Klllokot, Graçanicë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq*) nuk egziston regjistri i pronës komunale.

Në 20 komuna, për reduktimin e barrës administrative janë ndërmarrë veprime si në vijimi: *Bizneset janë liruar nga taksa komunale, lehtësimi i procedurave administrative, etj,* ndërsa në 18 komuna (*Ferizaj, Gjilan, Malishevë, Ranillug, Zubin Potok, Prishtinë, Podujevë, Viti, Klllokot, Zveçan, Gracanicë, Junik, Kaçanik, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Vushtrri, Mamushë, Novobërdë*) nuk është ndërmarrë asnjë veprim.

Ndërsa sa i përket funksionalizimit të zonave ekonomike, nga të dhënat e raportuara rezulton se në 11 komuna është bërë funksionalizimi i tyre, ndërsa në 26 komuna (*Ferizaj, Gjilan, Malishevë, Ranillug, Zubin Potok, Prishtinë, Podujevë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Viti, Istog, Klllokot, Hani Elezi, Zveçan, Vushtrri, Obiliq, Mamushë, Nobvobërdë, Deçan, Gracanicë, Kaçanik, Klinë, Skenderaj, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq*) nuk është bërë si dhe komuna e Junik nuk ka zona të ndara ekonomike.

I. Standardet Evropiane

1.1. Bujqësia dhe zhvillimi rural

Plan Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural e kanë hartuar 14 komuna, ndërsa 24 komuna (*Shtime, Ferizaj, Zubin Potok, Fushë Kosovë, Mitrovicë, Istog, Klllokot, Hani Elezi, Zveçan, Deçan, Graçanicë, Kaçanik, Klinë, Rahovec, Skenderaj, Pejë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë, Vushtrri, Mamushë, Novobërdë, Suharekë dhe Lipjan*) nuk e kanë hartuar ende.

Sa i përket numrit të kërkesave të parashtruara, pëlqimeve dhe vendimeve të lëshuara për ndërrimin e destinimit të tokës në 25 komuna është 280 kërkesa, ndërsa në 13 komuna (*Zubin Potok, Gjilan, Ranillug, Podujevë, Mitrovicë, Kamenicë, Zveçan, Klinë, Skenderaj, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Shtërpçë dhe Mamushë*) nuk kanë pasur asnjë kërkesë.


